

**RREGULLORE\***  
**Nr.8 datë 11.11.2009**

**PËR MASAT MENAXHUESE PËR SHFRYTËZIMIN E QËNDRUESHËM TË  
BURIMEVE PESHKORE NË DET**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.7908 datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë:

**KREU I**  
**FUSHA E VEPRIMTARISË DHE PËRKUFIZIMET**

**Neni 1**

**Fusha e veprimtarisë**

1. Kjo rregullore zbatohet:

a) për ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e resurseve ujore të gjalla kur këto aktivitete ushtrohen:

i) në territorin e ujërave detare, që i nënshtrohen sovranitetit apo juridiksionit të Republikës së Shqipërisë;

ii) nga anijet shqiptare të peshkimit në detin Mesdhe, jashtë zonave të përcaktuara në pikën “i”;

iii) nga shtetas shqiptarë, në detin Mesdhe, jashtë ujërave të përcaktuara në pikën “i”; dhe

b) për tregtimin e prodhimeve peshkore të zëna në Mesdhe.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për aktivitetet e peshkimit që ushtrohen vetëm për qëllime shkencore dhe që janë të pajisura me autorizimin përkatës, sipas nenit 10 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar.

**Neni 2**

**Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. “Vegla peshkimi me tërheqje”: çdo vegël peshkimi, me përjashtim të parangallëve, e tërhequr nga forca motorike e anijes së peshkimit, ose që ngrihet me anë të vinçave, me anijen e peshkimit të ankoruar, ose në lëvizje me shpejtësi të ulët, ku përfshihen në veçanti tratat dhe dragat:

a) me “trata” kuptojmë trata tërheqëse, trata zalli dhe trata krahu bregdetare;

i) me “trata tërheqëse”: rrjeta që janë të tërhequra në mënyrë aktive nga motori kryesor i anijes së peshkimit të përbëra nga një trup në formë konike ose piramidale, të mbyllur në fund me një thes që mund të zgjatet në hapje nëpërmjet krahëve ose që janë të montuara në një skelet të fortë, hapja horizontale sigurohet nëpërmjet timonëve ose nga një bosht, apo skelet në formë dhe dimensione të ndryshueshme; këto rrjeta mund të tërhiqen në fund të detit (trata koçe) ose në shtresat e ujit (trata tërheqëse pellagjike);

ii) me “trata zalli”: rrjeta me rrethim dhe trata krahu të tërhequra, të manovruara apo të ngritura nga kavot, apo tamburet e një anijeje të peshkimit në lëvizje ose të ankoruar dhe jo të tërhequra nga motori kryesor, të përbëra nga dy krahë anësorë dhe një xhep qendror në formë luge dhe të pajisura me thes në pjesën fundore; mund të përdoren që nga sipërfaqja deri në fund në varësi të llojeve që peshkohen;

\* Kjo rregullore përaftron pjesërisht Rregulloren e Bashkimit Evropian (EC) nr. 1967/2006 në lidhje me masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në detin Mesdhe dhe që modifikon rregulloren (CEE) n. 2847/93 dhe shfuqizon rregulloren (CE) n. 1626/94

iii) me “tratë krahut bregdetar” ose trata plazhi: rrjeta me rrethim ose trata krahut të hedhura nga një anije peshkimi dhe që manovrohen nga bregu;

b) “draga”: mjete që tërhiqen në mënyrë aktive nga motori kryesor i anijes së peshkimit (dragë e tërhequr nga mjet lundrues) për zënien e molusqeve bivalvorë, gastropodë dhe që përbëhen nga një thes rrjete ose një kafaz metalik të montuar mbi një shufër ose skelet të fortë me formë dhe dimensione të ndryshme ku pjesa e poshtme, mund të jetë e pajisur me një thikë që mund të jetë e rrumbullakosur, e mprehur ose e dhëmbëzuar dhe mund të jetë e pajisur ose jo me rrëshqitëse ose depresorë; ekzistojnë edhe draga të pajisura me aparatura hidraulike (draga hidraulike). Dragat që tërhiqen me dorë ose ngrihen me anë të një makaraje me dorë në ujërat e cekëta me ose pa pajisje lundrimi për zënien e molusqeve bivalvorë, gastropodë (dragat e dorës) nuk konsiderohen si mjete gjuetie me tërheqje sipas kësaj rregulloreje;

2. “Zonë e mbrojtur peshkimi”: një zonë detare e përcaktuar gjeografikisht, në të cilën aktiviteti i peshkimit është plotësisht ose pjesërisht i ndaluar në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, ose është objekt i kufizimeve më të larta për mirësimin e shfrytëzimit dhe ruajtjen e burimeve ujore të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve detare.

3. “Rrjeta fikse fundore”: një mrezhë, një njicë fundore ose një rrjetë fikse fundore e kombinuar.

4. “Mrezha”: rrjetë e përbërë nga dy ose më shumë copa rrjetash të fiksuara së bashku në paralel në të njëjtën cimë përforcuese dhe që është apo mund të jetë e ankoruar me çfarëdo mënyre në fundin e detit;

a) “njicë fundore”: rrjetë e formuar nga një copë e vetme dhe e mbajtur vertikalisht në ujë nëpërmjet plumbave dhe tapave dhe që është apo mund të jetë e ankoruar me çfarëdo mënyre në fund dhe që mbahet në afërsi të këtij fundi ose noton në kolonën e ujit;

b) rrjetë fikse fundore e kombinuar”: njicë fundore e pozicionuar në fund dhe që kombinohet me një mrezhë që përbën pjesën fundore të rrjetës.

5. “Rrjeta me rrethim”: rrjeta që i kapin peshqit duke i rrethuar nga anët dhe nga poshtë. Mund të jenë ose jo të pajisura me një kavo mbyllëse;

a) “koshilok”: rrjetë me rrethim, në të cilën pjesa e poshtme mbahet e mbledhur me anë të një kavoje e cila është e lidhur me kavon e plumbit me anë të disa unazave, që mundësojnë mbylljen e rrjetës. Koshilokët mund të përdoren për gjuetinë e llojeve pellagjike të vegjël ose të mëdhenj apo për ato fundore.

6. “Kurthe”: mjete peshkimi të fiksuara ose sistemuara në fund dhe që veprojnë si një kurth për zënien e llojeve detare. Janë të ndërtuara në formë të koshit, vazos, fuçisë apo kafazit dhe që në shumicën e rasteve përfshin një skelet të fortë ose gjysmë të fortë të përbërë nga materiale të ndryshme (dru, xunkth, shufra metalike, rrjete kavosh etj.) dhe që mund të jenë ose jo të mbuluara me rrjetë. Mund të kenë një ose disa hinka ose hyrje me cepa të lëmuar që lejojnë llojet të hyjnë në dhomat e brendshme. Mund të përdoren të vetme ose në grupe. Kur përdoret në grup, një litar kryesor mban shumë kurthe mbi litarë dytësorë që kanë gjatësi dhe hapësira të ndryshme në varësi të llojit që është objekt peshkimi.

7. “Parangallët”: mjet peshkimi që përmban një fije kryesore që përmban shumë grepa në disa fije dytësore (krahët) me gjatësi dhe hapësira të ndryshme, në varësi të llojit që është objekt peshkimi. Mund të vendosen horizontalisht dhe vertikalisht në lidhje me sipërfaqen e detit, mund të jenë të ankoruar në fund ose afër fundit (parangall fundor), ose që lihen të notojnë në mes të kolonës ujore ose afër sipërfaqes (parangall sipërfaqësor).

8. “Grep”: një copë fije çeliku e kthyer dhe me majë, zakonisht pajisur me kundërmajë. Maja e grepit mund të jetë e drejtë ose e harkuar dhe e rikthyer; këmba e grepit mund të jetë me gjatësi dhe formë të ndryshme dhe seksioni i saj mund të jetë i rrumbullakët (i rregullt) ose i sheshtë (i farkëtuar). Gjatësia e përgjithshme e grepit i korrespondon gjatësisë maksimale të përgjithshme të këmbës së grepit të matur që nga fundi i grepit që nevojitet për lidhjen e fijes me grepin, zakonisht në formë syri, deri te fundi i qafës së grepit; Gjerësia e grepit i korrespondon gjerësisë maksimale horizontale nga pjesa e jashtme e këmbës së grepit deri te pjesa e jashtme e kundërmajës.

9. “Peshkim shlodhës/kohës së lirë” – peshkim jo i drejtuar për shfrytëzim ekonomik (që do të thotë jo për shitje, shkëmbim ose tregtim) i motivuar nga përdorimi personal për shlodhje, turizëm apo sport. Zëniet nga peshkimi i kohës së lirë (shlodhës) ose lihen të lira (lëshohen), ose mbahen për konsum privat. Peshkim shlodhës/kohës së lirë përfshin këto tre nënkategori:

a) Peshkimi amator – peshkim i kohës lirë i paorganizuar, i palidhur me ngjarje ose gara të përcaktuara, pa mjete lundruese;

b) Peshkim sportiv – peshkim i organizuar që përfshin garimin e lirë midis peshkatarëve për të zënë individin (peshkun) më të madh të disa llojeve, numrin më të madh të individëve ose peshën më të madhe të përgjithshme në varësi të rregullave të çdo gare të veçantë;

c) Peshkim turistik-peshkim i kryer nga peshkatarë profesionistë ose nga profesionistë të peshkimit shlodhës (charter) të konisderuar si palë e tretë, e cila organizon ekspeditat e peshkimit.

10. “Dispozitiv për përqendrimin e peshqve (DPP)”: çdo lloj mjeti notues në sipërfaqe, i aftë të përqendrojë në zonën poshtë tij rasate ose individë të rritur të llojeve shumë migruese.

11. “Kryqi i Shën Andreas”: mjet për mbledhjen nga fundi i detit, më një veprim në formë gërshëre, të moluskut bivalvor, *Pinna nobilis* ose të koralit të kuq.

12. “Livadh detar”: zonë në të cilën fundi detar karakterizohet nga prania dominante e fanerogameve ose në të cilën kjo bimësi ka ekzistuar dhe ka nevojë për ndërhyrje rehabilitimuese.

Livadh detar është një përkufizim i përbashkët për llojet *Posidonia oceanica*, *Cymodocea nodosa*, *Zoostera marina* dhe *Zoostera noltii*.

13. “Habitat koraligjen”: zonë në të cilën fundi detar karakterizohet nga prania dominante e një komuniteti specifik biologjik të emërtuar “koraligjen”, ose ku komunitet ka ekzistuar dhe ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese. Koraligjene është një përkufizim i përbashkët për një strukturë shumë komplekse biogjenike, që është rezultat i mbivendosjes së vazhdueshme, mbi një substrat paraekzistues shkëmbor ose të fortë, të shtresave gëlqerore që rrjedhin kryesisht nga aktiviteti ndërtues, me anë të formimit të koreve gëlqerore, të algave të kuqe koralinore dhe të organizmave shtazore si *Porifera*, *Ascidi*, *Knidarë* (gorgonie, korale te buta etj.), *Briozoarë*, *Serpulidët*, *Anelidët* së bashku me organizma të tjerë fiksues-gëlqeror.

14. “Shtrat detar maerl”: zonë në të cilin fundi detar karakterizohet nga prania mbizotëruese e një komuniteti specifik biologjik të emërtuar “maerl” ose ku ky komunitet ka ekzistuar dhe ka nevojë për ndërhyrje rehabilituese. Maerl është një përkufizim i përbashkët për një strukturë biogjenike të përbërë nga lloje të ndryshme algash të kuqe koraline (*Corallinaceae*), të cilat kanë një skelet të fortë prej kalciumi dhe rriten në fundin e detit si alga koraline me degëzime të lira, me degëza ose nyje, duke formuar sedimentet në palat e fundeve detare ranore ose baltore. Shtratet detare të maerl janë zakonisht të përbëra nga një ose disa lloj algash koralore të kombinuara në mënyra të ndryshme, si *Lithothamnion coralloides* dhe *Phymatolithon calcareum*.

15. “Ripopullimi i drejtpërdrejtë”: aktiviteti i lëshimit të organizmave të egër të gjallë të llojeve të seleksionuara në ujëra në të cilat ato ndodhen të pranishme në mënyrë natyrale, me qëllim që të shfrytëzohet prodhimentaria natyrale e ambientit ujqor për të shtuar numrin e individëve në dispozicion të aktivitetit të peshkimit dhe/ose zmadhimin e rekrutimit natyral.

16. “Trapiantim”: proces në të cilin një lloj transportohet dhe lëshohet në mënyrë të qëllimshme nga njeriu brenda një zone në të cilën ai është i pranishëm dhe ka një fluks gjenetik të vazhdueshëm.

17. “Lloj jo autokton”: një lloj ambienti natyral historikisht i njohur i të cilit, ndodhet jashtë zonës së marrë në konsideratë.

18. “Introduktim”: procesi në të cilin një lloj jo autokton transportohet dhe lëshohet qëllimisht nga njeriu në zonat jashtë ambientit natyral historikisht të njohur të tij.

## KREU II LLOJET DHE HABITATET E MBROJTURA

### Neni 3

#### **Llojet e mbrojtura**

1. Është e ndaluar zënia, mbajtja në anije, transbordimi apo zbarkimi i qëllimshëm i llojeve detare të përcaktuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe nenit 48 të rregullores nr.1, datë 29.3.2005 “Për zbatimin e ligjshmërisë në peshkim dhe akuakulturë”.

2. Mbjtja në anije, transbordimi dhe zbarkimi i individëve i llojeve detare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni të zëna aksidentalisht, lejohet nëse kemi të bëjmë me aktivitete të nevojshme për dhënien e ndihmës për rekuperimin e këtyre individëve të zënë dhe me kushtin që Inspektorati i Peshkimit të informohet në mënyrë të plotë, paraprakisht.

### Neni 4

#### **Habitatet e mbrojtura**

1. Është i ndaluar peshkimi me trata koçe, draga, kurthe, koshilok, trata zalli, trata krahu bregdetare dhe rrjeta të ngjashme në fundet me bimësi, sidomos të *Posidonia oceanica* dhe fanerogameve të tjera detare.

Si përjashtim i pikës 1, lejohet përdorimi i koshilokut, tratave të zallit dhe rrjetave të ngjashme, në të cilat lartësia totale dhe sjellja gjatë aktivitetit të peshkimit nënkuptojnë që koshiloku, kavo e plumbit dhe kavot e tërheqjes nuk prekin livadhet.

2. Është i ndaluar peshkimi me trata koçe, draga, trata zalli, trata krahu bregdetare dhe rrjeta të ngjashme mbi habitatet koraligjene dhe mbi shtratet detare të maerl.

3. Është i ndaluar përdorimi i dragave me tërheqje dhe tratave për peshkim në thellësi më të mëdha se 1 000 metra.

4. Ndalimet e parashikuara në paragrafin e dytë të pikës 1 të këtij neni dhe në pikën 2 të tij, do të aplikohen nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje në të gjithë zonat e bregdetit shqiptar.

## KREU III

### ZONAT E MBROJTURA TË PESHKIMIT

### Neni 5

#### **Procedurat e informimit për përcaktimin e zonave të mbrojtura të peshkimit**

Inspektorati i Peshkimit, brenda datës 31 dhjetorit 2010, informon ministrinë duke dërguar informacionet e nevojshme për përcaktimin e zonave të mbrojtura të peshkimit dhe të masave menaxhuese të mundshme që do të aplikohen në to si brenda, ashtu edhe jashtë ujërave që hyjnë në juridiksionin Republikën e Shqipërisë, atëherë kur mbrojtja e zonave të rritjes, të

riprodhimit apo të ekosistemit detar nga efektet e dëmshme të peshkimit, kërkon masa të veçanta.

Neni 6

### **Zonat e mbrojtura të peshkimit**

1. Ministria, brenda dy vjetëve nga miratimi i kësaj rregulloreje, bazuar mbi informacionet e marra sipas nenit 5 të saj, përcakton zona të tjera të mbrojtura peshkimi, krahasuar me zonat e mbrojtura të peshkimit që ekzistojnë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda ujërave territoriale në të cilat aktiviteti i peshkimit mund të jetë i ndaluar ose i kufizuar me qëllim që të ruhen dhe menaxhohen burimet ujore të gjalla apo të ruhet apo përmirësohet gjendja e ekosistemeve detare. Ministria vendos masa teknike të përshtatshme, të cilat duhet të jenë jo më pak shtrënguese sesa ato të parashikuara nga legjislacioni i BE-së në lidhje me mjetet e peshkimit të autorizuar në këto zona të mbrojtura.
2. Ministria mund të përcaktojë zona të tjera të mbrojtura të peshkimit apo të ndryshojë kufijtë, apo masat e menaxhimit të parashikuara në pikën 1, bazuar në informacione të reja shkencore. Ministria merr masat e nevojshme për të garantuar mbledhjen e informacionit të duhur shkencor për të mundësuar identifikimin dhe ilustrimin në harta shkencore të zonave që duhen mbrojtur në lidhje me këtë nen.
3. Masat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, publikohen dhe në mënyrë të veçantë u bëhet e njohur rezidentëve të zonës së autoriteteve lokale me mjete të përshtatshme nëpërmjet afishimit në vende publike, publikimi në shtyp e mjeteve të tjera të informacionit. Në zbatimin e dispozitave të parashikuara në pikat 1 dhe 2, ministria publikon motivimet shkencore, teknike dhe ligjore ku bazohet nevoja e këtyre masave të veçanta.
4. Në rastet kur ministria vlerëson që masat e menaxhimit të peshkimit të përcaktuara në pikën 2 nuk janë të mjaftueshme për të garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje të resurseve dhe të mjedisit, mund të bëjë modifikimin e masave ose të adoptojë masa të menaxhimit të peshkimit shtesë në lidhje me ujërat e marra në konsideratë.

## **KREU IV**

### **KUFIZIMET NË LIDHJE ME VEGLAT E PESHKIMIT**

Neni 7

### **Format dhe mjetet e ndaluara për peshkim**

1. Është i ndaluar përdorimi dhe mbajtja në anije e:
  - a) substancave toksike, narkotike dhe gërryese;
  - b) pajisjeve që gjenerojnë shkarkime elektrike;
  - c) eksplozivëve;
  - d) substancave që nëse bashkohen së bashku, mund të shpërthejnë;
  - e) mjeteve me tërheqje që përdoren për mbledhjen e koralit të kuq dhe llojeve të tjera të koraleve apo organizmave të tjerë të ngjashëm me koralet;
  - f) çekiçëve pneumatikë ose pajisjeve të tjera me goditje për grumbullimin, sidomos të molusqeve bivalvorë të futur në shkëmb;
  - g) kryqeve të Shën Andreas apo pajisjeve të ngjashme me to që përdoren, sidomos për mbledhjen e koralit të kuq dhe llojeve të tjera të koraleve apo organizmave të tjerë të ngjashëm me koralet;
  - h) pjesëve të rrjetës me syze më të vogël se 40 milimetra për tratat e koqes.
2. Është i ndaluar përdorimi i rrjetave fundore për zënien e llojeve të mëposhtme: toni pendëgjatë (*Thunnus alalunga*), toni i kuq (*Thunnus thynnus*), peshku shtizë (*Xiphias*

*gladius*), Brama brama, peshkaqenëve (*Hexanchus griseus*; *Cetorhinus maximus*; *Alopiidae*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Isuridae* dhe *Lamnidae*).

Si përjashtim të sa më sipër, për zëniet joobjekt peshkimi, aksidentale të jo më shumë se tre individëve të llojeve të peshkaqenëve të përmendur më sipër, mund të mbahen në anije dhe të zbarkohen në rastet kur ato nuk janë lloje të mbrojtura sipas ligjeve ndërkombëtare.

3. Janë të ndaluara zënia, mbajtja në anije, transbordimi, zbarkimi, magazinimi, shitja, dhe ekspozimi apo vënia në shitje e gurëshpuesit (*Lithophaga lithophaga*) dhe të *Pholas dactylus*.

4. Pushkët nënujore janë të ndaluara nëse përdoren së bashku me respiratorë nënujorë (autorespirator) apo natën nga perëndimi deri në agim.

5. Janë të ndaluara zënia, mbajtja në anije, transbordimi, zbarkimi, magazinimi, shitja dhe ekspozimi apo vënia në shitje e femrave të pjekura seksualisht të aragostave (*Palinuridae spp.*), dhe të *astakuas*, (*Homarus gammarus*). Femrat të pjekura seksualisht të këtyre llojeve hidhen në det menjëherë pas zënies aksidentale.

Neni 8

### **Dimensionet minimale të syzeve të rrjetës**

1. Është i ndaluar përdorimi për peshkim dhe mbajtja në anije e tratave, rrjetave me rrethim apo njicave fundore, përveç rasteve kur madhësia e syzes në ato pjesë të rrjetës ku ajo është më e vogël, të jetë në përputhje me pikat nga 3 deri në 6 të këtij neni.

2. Madhësia e syzes është e përcaktuar me rregullore të veçantë të ministrisë.

3. Për tratat, përveç atyre që i referohet pika 4, madhësia minimale e syzes së rrjetës është:

a) deri më 31 janar 2009; 40 milimetra;

b) nga 1 shkurti 2010, rrjeta e parashikuar në pikën 1, zëvendësohet me një copë rrjete që ka syze kuadrate me madhësi 40 milimetra në thes, ose pas një kërkesë të motivuar plotësisht nga pronari i anijes, me një rrjetë romboidale me madhësi syze 50 milimetra.

Në lidhje me nënpikën e mësipërme, anijet e peshkimit janë të autorizuar të përdorin apo mbajnë në anije vetëm një nga dy llojet e rrjetave.

4. Për tratat që kanë qëllim peshkimin e sardeles dhe açugës, kur këto lloje përbëjnë të paktën 80% të zënieve si peshë e gjallë, të matura pas seleksionimit, madhësia minimale e syzes do të jetë 20 milimetra.

5. Për rrjetat me rrethim, madhësia minimale e syzes është 14 milimetra:

6a) Madhësia e syzes së rrjetës për njicat fundore nuk duhet të jetë më e vogël se 16 milimetra.

b) Për njicat fundore që kanë si objekt peshkimi spalcën e kuqe (*Pagellus bogaraveo*), kur ky lloj përfaqëson së paku 20% të zënieve si peshë e gjallë, madhësia minimale e syzes së rrjetës është 100 milimetra.

7. Ministria mund të lejojë përjashtime nga dispozitat e pikave 3, 4 dhe 5 për tratat e zallit dhe tratat e krahut bregdetar, të cilat hyjnë në një plan menaxhimi të parashikuar në nenin 17, me kusht që ky lloj peshkimi të jetë shumë selektiv dhe të ketë një efekt të papërfillshëm mbi mjedisin detar.

8. Ministria siguron të dhënat e përditësuara dhe motivimet teknike për këtë lloje përjashtimi.

Neni 9

### **Madhësia minimale e grepave**

Janë të ndaluara përdorimi për peshkim dhe mbajtja në anije e parangallëve me grepa me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 3,95 centimetra dhe me gjerësi më të vogël se 1,65 centimetra për anijet e peshkimit që përdorin parangallët dhe që zbarkojnë ose mbajnë në

anije një sasi të spalçës së kuqe (*Pagellus bogaraveo*) më të madhe se 20 % të peshës së gjallë të zënieve të matura pas seleksionimit.

Neni 10

#### **Montimi i pajisjeve dhe armimi i tratave**

1. Është i ndaluar në secilën pjesë të rrjetës, bllokimi i syzeve apo reduktimi faktik i dimensioneve, përveçse kur autorizohet me rregullore të veçantë ministri ose sipas rasteve të parashikuara në shtojcën I(a) të kësaj rregulloreje.
2. Armimi i tratave duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën I pika (b) të kësaj rregulloreje.

Neni 11

#### **Dimensionet e veglave të peshkimit**

Është e ndaluar mbajtja në anije ose përdorimi në det i veglave të peshkimit që nuk janë në përputhje me dimensionet e parashikuara në shtojcën II.

Neni 12

#### **Vlerat minimale të largësisë dhe thellësisë për përdorimin e veglave të peshkimit**

1. Është i ndaluar përdorimi i veglave të peshkimit me tërheqje në një largësi më të vogël se 3 milje detare nga vija bregdetare ose në brendësi të izobatës 50 metra kur një thellësi e tillë arrihet në një largësi më të vogël nga bregu.  
Si përjashtim të pikës së parë, lejohet përdorimi i dragave në një largësi më të vogël se 3 milje detare, pavarësisht nga thellësia, me kusht që llojet e ndryshme nga molusqet e zëna të mos kalojnë 10 % të peshës së gjallë të zënieve.
2. Është i ndaluar përdorimi i rrjetave me tërheqje në një largësi më të vogël se 1.5 milje detare nga vija bregdetare. Është i ndaluar përdorimi i dragave të tërhequra nga mjete lundruese dhe dragave hidraulike në një largësi më të vogël se 0,3 milje detare nga vija bregdetare.
3. Është i ndaluar përdorimi i koshilokëve në largësi më të vogël se 300 metra nga vija bregdetare ose brenda izobatës 50 metra në rastet kur kjo thellësi arrihet në një largësi më të vogël nga bregu.  
Koshilokët nuk vendosen në thellësi më të vogël se 70 % e lartësisë së përgjithshme të vetë koshilokut, sipas kriterëve të matjes, të parashikuar në shtojcën II të kësaj rregulloreje.
4. Ministria autorizon një shtyrje të afatit për pikat 1, 2 dhe 3, me kusht që një shtyrje e afatit e tillë të jetë e justifikuar nga rrethanat të veçanta gjeografike, si shtrirja e kufizuar e platformave bregdetare përgjatë vijës bregdetare ose madhësia e kufizuar e zonave për peshkim me trata, në rastet kur aktivitetet e peshkimit nuk kanë një ndikim domethënës në mjedisin detar dhe prekin një numër të kufizuar mjedesh lundruese, dhe me kusht që ato të mos ushtrohen me anë të veglave të tjera të peshkimit dhe të hyjnë në kuadër të një plani menaxhimi parashikuar në nenet 17 dhe 18. Ministria duhet të sigurojë të dhënat shkencore dhe teknike të përditësuara që e justifikojnë një shtyrje afati të tillë.
5. Si përjashtim të pikës 2, tratat mund të përdoren përkohësisht deri më 31 janar 2010 në një largësi nga bregu më të vogël se 1,5 milje, me kusht që thellësia të jetë më e madhe se e izobatës 50 metra.
6. Si përjashtim i pikës 3, koshilokët mund të përdoren përkohësisht deri më 31 janar 2010, në një largësi nga bregu më të vogël se 300 metra dhe thellësi më të vogël se izobata 50 metra, por jo më të vogël se izobata 30 metra. Koshilokët mund të përdoren përkohësisht deri

më 31 janar 2010 në një thellësi më të vogël se 70 % e lartësisë së përgjithëshme të vetë koshilokut sipas kriterëve të matjes të parashikuara në Shtojcën II të kësaj rregulloreje.

7. Si përjashtim të pikës 2, dragat e tërhequra nga mjete lundruese dhe dragat hidraulike mund të përdoren përkohësisht deri më 31 janar 2010 brenda një largësie më të vogël se 0,3 milje detare.

8. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 5 do të aplikohet vetëm ndaj aktiviteteve të peshkimit që kanë qenë të pajisura me leje dhe ndaj mjeteve lundruese që kanë një aktivitet të vërtetuar në peshkim prej më shumë se 5 vjetësh dhe nuk sjell në të ardhmen asnjë rritje të sforcos së peshkimit të parashikuar.

Këto aktivitete duhet gjithashtu:

a) të plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 4, në germën “h” të pikës 1 të nenit 7, në germën “b” të pikës 3 të nenit 8, si dhe në pikën 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062, datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”;

b) të mos ndërhyjë në aktivitetin e mjeteve lundruese që përdorin vegla të ndryshme nga tratat, koshilokët apo tratat e ngjashme me tërheqje;

c) të jenë të rregulluara në mënyrë të tillë që të garantojnë që zëniet e llojeve të përfshira në shtojcën III, me përjashtim të molusqeve bivalvë, të jenë sa më të vogla;

d) të mos jenë të orientuara drejt cefalopodëve.

Ministria harton një plan monitorimi çdo 3 vjet që nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

9. Mund të lejohen përjashtime për pikat 1 dhe 2 për zonat e peshkimit në të cilat është akorduar një shtyrje e afatit sipas nenit 4, pika 5, të kësaj rregulloreje.

10. Si përjashtim i pikës 2, autorizohet përdorimi i tratave në një largësi midis 0.7 dhe 1.5 milje detare nga bregu me kushtet e mëposhtme:

- thellësia e detit të jetë jo më e vogël se izobata 50 metra;

- rrethana të veçanta gjeografike, si shtrirja e kufizuar e platformave bregdetare përgjatë gjithë vijës bregdetare të zonës ose madhësia e kufizuar e zonave për peshkim me trata;

- të mos ketë asnjë ndikim domethënës mbi mjedisin detar;

- të jetë konform me pikën 8, germat “a” dhe “b”;

- të mos sjellë asnjë rritje në sforcën e peshkimit në krahasim me sa është autorizuar nga ministria.

11. Ministria brenda 31 majit 2010 publikon modalitetet e aplikimit të këtyre shtyrjeve të afatit. Ky publikim duhet të përmbajë një listë të anijeve të peshkimit të autorizuar dhe të zonave të autorizuar, së bashku me koordinatat respektive gjeografike si detare, ashtu dhe tokësore.

12. Ministria mbikëqyr aktivitetin e peshkimit në zonat e përcaktuara si më sipër dhe garanton vlerësimin shkencor.

### Neni 13

#### **Përjashtime kalimtare të madhësive minimale të syzeve dhe të largësisë minimale nga bregu për përdorimin e veglave të peshkimit**

1. Çdo vegël peshkimi, e parashikuar në pikat 3,4 dhe 5 të nenit 8, madhësitë e syzeve të së cilave janë më të vogla se ato të parashikuara, mund të përdoret deri më 31 maj 2010, megjithëse nuk respektojnë kërkesat e pikës 8 të nenit 12.

2. Çdo vegël peshkimi, e parashikuar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 12, e përdorur në një largësi nga bregu më të vogël se ato të parashikuara, mund të përdoren deri më 31 maj 2010, megjithëse nuk respektojnë kërkesat e pikës 8 të nenit 12.

## DIMENSIONET MINIMALE TË ORGANIZMAVE DETARË

Neni 14

### **Dimensionet minimale të organizmave ujorë**

1. Një organizëm ujor, i cili është më i vogël se dimensionimi minimal i parashikuar në shtojcën III (këtej e tutje: “organizmat detarë nën dimension”) nuk mund të peshkohen, mbahen në anije, transbordohen, zbarkohen, transferohen, magazinohen, shiten, paraqiten apo nxirren për shitje.
2. Dimensionet e organizmave detarë maten konform shtojcës IV. Në rastet kur lejohen disa metoda matjeje, organizmat detarë do të kenë madhësinë e parashikuar në rast se të paktën njëra nga matjet e përcaktuara me anë të kësaj metode është e barabartë ose më e madhe se dimensionimi minimal që i korrespondon.
3. Pika 1 nuk aplikohet për të vegjëlit e sardeles të zbarkuara me qëllim konsumin njerëzor nëse këta të vegjël janë kapur me trata zalli ose trata krahu bregdetare dhe autorizuar konform dispozitave ligjore të parashikuara në një plan menaxhimi sipas nenit 18, me kusht që stoku i sardeleve të hyjë brenda kufijve biologjikë të sigurisë.

Neni 15

### **Ripopullimi i drejtpërdrejtë ose trapiantimi**

1. Si përjashtim të nenit 14, organizmat detarë nën dimension mund të peshkohen, mbahen në anije, transbordohen, zbarkohen, transferohen, magazinohen, shiten, paraqiten apo nxirren në shitje të gjalla me qëllim ripopullimin e drejtpërdrejtë apo trapiantimin me lejen dhe autorizim të Ministrisë.
2. Ministria siguron që zënia e organizmave detarë nën dimensione parashikuara në pikën 1 të ndodhë sipas modaliteteve në përputhje me masat menaxhuese të aplikueshme për llojet në fjalë.
3. Organizmat e zëna të parashikuara në pikën 1, duhet të rihidhen në det ose të përdoren për akuakulturë ekstensive. Në qoftë se kapen në një kohë të dytë, ato mund të shiten, magazinohen, paraqiten apo nxirren në shitje, me kusht që të kënaqin kërkesat e parashikuara në nenin 14.
4. Është i ndaluar introduktimi, trapiantimi dhe ripopullimi i drejtpërdrejtë me lloje jo autoktone.

## KREU VI PESHKIMI JOPROFESIONAL

Neni 16

### **Peshkimi shlodhës/i kohës së lirë**

1. Në peshkimin shlodhës/kohës së lirë është i ndaluar përdorimi i tratave, rrjetave me rrethim, koshilokëve, dragave, dragave të mekanizuara, njicave, mrezhave, rrjetave fikse fundore të kombinuara. Gjithashtu në kuadër të peshkimit sportiv është i ndaluar përdorimi i parangallëve për zëniet e llojeve shumë migruese.
2. Ministria merr masa që peshkimi shlodhës/kohës së lirë të praktikohet sipas modaliteteve konform objektivave dhe normave të kësaj rregulloreje.
3. Ministria merr masa që zëniet e organizmave detarë të kryera në kuadër të peshkimit shlodhës /kohës së lirë të mos tregtohen. Megjithatë në raste të veçanta mund të autorizohet

tregtimi i llojeve të zëna në kuadër të garave sportive, me kusht që fitimi i përgjithshëm i shitjeve të tyre të jetë destinuar për qëllime bamirësie.

4. Ministria merr masa për regjistrimin dhe mbledhjen e veçantë të të dhënave në lidhje me zëniet e llojeve shumë migruese sipas shtojcës V të kryera në kuadër të peshkimit shlodhës /kohës së lirë në detin Mesdhe.

5. Ministria rregullon dhe peshkimin nënujor me pushkë nënujore, sidomos për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 8, pika 4.

## KREU VII PLANET E MENAXHIMIT

Neni 17

### **Planet e menaxhimit në nivel kombëtar**

1. Ministria adopton plane menaxhimi për aktivitetin specifik të peshkimit në Adriatik dhe Jon. Këto plane mund të përfshijnë veçanërisht:

a) masa të menaxhimit të sforcos së peshkimit;

b) masa specifike teknike, përfshirë aty ku mendohet e nevojshme dhe të përjashtimeve të përkohëshme nga normat e kësaj rregulloreje, aty ku këto përjashtime janë të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të peshkimit, me kusht që ky plan menaxhimi të garantojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve të marra në konsideratë;

c) shtrirjen si përdorim të detyrueshëm të sistemit të kontrollit me anë të satelitit VMS apo të sistemeve të ngjashme për anijet e peshkimit me gjatësi të përgjithshme të përfshirë midis 10 dhe 15 metra;

d) kufizime të përkohshme apo të përhershme në disa zona, të rezervuara për disa lloj mjetesh peshkimi apo anijesh që kanë nënshkruar detyrimet në kuadrin e planit të menaxhimit.

Planet e menaxhimit parashikojnë lëshimin e lejeve të veçanta të peshkimit të anijeve të peshkimit me gjatësi të përgjithëshme më të vogël se 10 metra.

2. Komisionet konsultative lokale paraqesin sugjerime ministrisë në lidhje me përcaktimin e planeve të menaxhimit. Ministria u përgjigjet këtyre kërkesave brenda tre muajve nga marrja e tyre.

3. Ministria kryen një monitorim të përshtatshëm shkencor të planeve të menaxhimit. Në veçanti, disa masa menaxhuese në lidhje me aktivitetet e peshkimit që shfrytëzojnë llojet me cikël të shkurtër jetësor rishikohen çdo vit për të pasur parasysh ndryshimet e mundshme në forcën e rekrutimit.

Neni 18

### **Planet e menaxhimit për disa nga aktivitetet e peshkimit në nivel lokal**

1. Ministria, brenda datës 31 dhjetori 2010, adopton plane menaxhimi për aktivitetet e peshkimit të kryera me trata, trata zalli, trata krahu bregdetare, rrjeta me rrethim dhe draga për zona të caktuara të bregdetit.

2. Ministria mund që të hartojë plane të tjera menaxhimi, bazuar mbi të dhëna të reja të rëndësishme shkencore edhe në një kohë të dytë.

3. Planet e menaxhimit mund të përfshijnë dhe masa që shkojnë përtej dispozitave të kësaj rregulloreje, me qëllim:

a) rritjen e selektivitetit të mjeteve të peshkimit;

b) reduktimin e hedhjes së peshkut në det;

c) kufizimin e sforcos së peshkimit.

4. Masat që përfshihen në planet e menaxhimit janë në përpjestim dhe me qëllimet, objektivat dhe afatet e parashikuara, dhe duhet të mbajnë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- a) gjendja e ruajtjes së rezervës apo rezervave;
- b) karakteristikat biologjike të rezervës apo rezervave.
- c) karakteristikat e aktiviteteve të peshkimit, i cili peshkon këtë rezervë;
- d) impaktin ekonomik të këtyre masave në aktivitetin e peshkimit që preket nga to.

## KREU VIII MASAT E KONTROLLIT

Neni 19

### **Zënia e llojeve objekt peshkimi**

1. Përqindjet të cilave u referohen pikat 4 dhe 6 të nenit 8, neni 9 dhe pika 1 e nenit 12, janë përlllogaritur në raport të peshës së gjallë të gjithë organizmave ujorë që ndodhen në anije pas seleksionimit ose në momentin e zbarkimit. Ato mund të llogariten bazuar në një ose disa marrje të mostrave përfaqësuese.

2. Në rastin e anijeve të peshkimit, nga të cilat janë transborduar organizma ujorë të gjallë, këto sasi duhet të merren në konsideratë në llogaritjen e përqindjeve që i referohen pikës 1.

Neni 20

### **Transbordimet**

Transbordimi i organizmave ujorë të gjallë në anije të tjera peshkimi apo marrja e organizmave të tillë nga anije të tjera peshkimi lejohet vetëm kapitenëve të anijeve të peshkimit të cilët mbajnë një libër anijeje sipas pikës 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1062, datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e një sistemi kontrolli për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”.

Neni 21

### **Portet e përcaktuara**

1. Zëniet e kryera nga tratat koçe, tratat pellagjike, koshilokët, parangallët pellagjikë, dragat e tërhequra nga mjete anije peshkimi dhe draga hidraulike mund të zbarkohen dhe tregtohen për herë të parë vetëm në portet e caktuara nga Ministria.

2. Si zbatim i pikës 1, porti i peshkimit-Shëngjin, porti i peshkimit-Durrës, porti i peshkimit - Vlorë dhe porti i peshkimit - Sarandë, janë porte të miratuara nga ministria.

Neni 22

### **Regjistri i anijeve të autorizuar për peshkim në zonën e marrëveshjes së KPPM**

1. Drejtoria krijon dhe mban regjistrin kombëtar të mjeteve lundruese në format elektronik. Pjesë e këtij regjistri është edhe lista e anijeve që kanë flamurin shqiptar dhe të regjistruara në territorin shqiptar, dhe të autorizuar për peshkim në zonën KPPM përmes lëshimit të një lejeje peshkimi.

2. Lista parashikuar në pikën 1 parashikon informacionet e mëposhtme:

- a) numri i regjistrimit të anijes në regjistrin e flotës kombëtare (NFR) dhe markimin e jashtëm;
- b) periudhën e autorizuar për peshkim dhe/ose transbordim;
- c) veglat e peshkimit të përdorura.

3. Brenda 1 korrikut, ministria i transmeton listën sekretariatit ekzekutiv të KPPM, në mënyrë që këto anije të mund të regjistrohen në regjistrin e KPPM-së, të anijeve që kanë gjatësi më të madhe se 15 metra të autorizuar për të peshkuar në zonën e marrëveshjes KPPM (këtej e tutje i emërtuar “regjistri KPPM”).

4. Çdo ndryshim në listën e parashikuar në pikën 1 i komunikohet sekretariatit ekzekutiv të KPPM, sipas së njëjtës procedurë, të paktën 10 ditë pune përpara datës në të cilën anijet fillojnë aktivitetin e peshkimit në zonën KPPM.

5. Anijet e peshkimit shqiptare me gjatësi të përgjithshme më të madhe se 15 metra, që nuk janë të regjistruara në listën e parashikuar në pikën 1, nuk mund të peshkojnë, mbajnë në anije, transbordojnë apo zbarkojnë asnjë lloj peshku apo molusku në zonën KPPM.

6. Ministria merr masat e nevojshme për të siguruar që:

a) vetëm anijet që kanë flamurin shqiptar dhe që janë regjistruar në listën e parashikuar në pikën 1 dhe që kanë në anije një licencë peshkimi të lëshuar nga ministria të jenë të autorizuar, sipas kushteve të përcaktuara në leje, për të kryer aktivitetin e peshkimit në zonën KPPM;

b) të mos lëshohet asnjë lejeje peshkimi të anijeve që kanë kryer aktivitet peshkimi ilegal, të parregulluar apo të paraportuar (peshkim IUU) në zonën KPPM apo diku tjetër, përveç rasteve kur pronarët e rinj të sigurojnë evidencat e përshtatshme të dokumentuara që pronarët dhe operatorët e vjetër të mos kenë më asnjë interes financiar, juridik apo përfitues në lidhje me këto anije, si dhe nuk ushtrojnë asnjë kontroll mbi to, ose që anijet e tyre as nuk marrin pjesë dhe as nuk janë të përfshira në peshkim IUU;

c) të ndalojë pronarët dhe operatorët e anijeve që kanë flamurin e tyre dhe që janë të listuara në pikën 1, të marrin pjesë ose të zhvillojnë aktivitete peshkimi në zonën e marrëveshjes së KPPM, në anije që nuk janë të përfshira në regjistrin KPPM;

d) që pronari dhe operatorët e anijeve që kanë flamurin e tyre dhe që janë të përfshira në listën e parashikuar në pikën 1 të kenë shtetësinë ose të jenë njësi juridike shqiptare;

e) anijet e tyre të jenë në përputhje me të gjitha masat në lidhje me menaxhimin dhe konservimin të KPPM.

7. Ministria merr masat e duhura për të ndaluar peshkimin, mbajtjen në anije, transbordimin, dhe zbarkimin e peshqve dhe molusqeve në zonën e KPPM nga anijet që kanë një gjatësi të përgjithshme më të madhe se 15 metra dhe që nuk janë të përfshira në listën e KPPM.

8. Ministria njofton vendin, flamurin e të cilës anija mban, si dhe Komisionin Evropian, nëse anija është e një vendi të Bashkimit Evropian, çdo informacion në bazë të së cilës ka motive të forta për të dyshuar që anije me gjatësi të përgjithshme më të madhe se 15 metra që nuk janë të përfshira në listën e KPPM, ushtrojnë aktivitet peshkimi ose transbordimi të peshqve apo molusqeve në zonën e marrëveshjes KPPM.

Neni 23

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE  
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
**Fatmir Mediu**

SHTOJCA I

KUSHTE TEKNIKE PËR MONTIMIN E PAJISJEVE DHE ARMIMIN E TRATAVE

Përkufizimet

Në kuptim të kësaj shtojce do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

- a) “pjesë rrjete me fije të shumëfishtë”: një pjesë rrjete me dy ose më shumë fije, të cilat mund të jenë të ndara midis nyjeve pa dëmtuar strukturën e fijeve;
- b) “pjesë rrjete pa nyje”: një pjesë rrjete e ndërtuar me syze me katër anë që formojnë afërsisht një kuadrat në të cilën këndet e syzeve formohen nga kryqëzimi i fijeve të dy brinjëve të afërta të syzes;
- c) “pjesë rrjete me syze kuadrate”: një pjesë rrjete e ndërtuar në mënyrë të tillë që dy seritë e linjave paralele të formuara nga brinjët e syzeve të jenë njëra paralel dhe tjetra pingul me aksin gjatësor të rrjetës;
- d) “trupi i rrjetës”: seksion në formë konike e ndodhur në pjesën e përparme të tratës;
- e) “parathesi”: seksion cilindrik, i përbërë nga një ose disa panele, i ndodhur midis trupit të rrjetës dhe thesit;
- f) “thesi”: pjesa e pasme e një trate, e përbërë nga një pjesë rrjete me të njëjtën madhësi syze, që ka formë cilindrike ose konike, seksionet e tërthorta të së cilës formojnë përafërsisht rrathë me rreze identike ose rreze zvogëluese;
- g) “thes në formë topi”: thes i ndërtuar nga një ose disa panele ngjitur, me syze të të njëjtit dimension, në të cilin numri i syzeve rritet drejt pjesës së pasme duke sjellë një zmadhim si të gjatësisë së tërthortë në krahasim me aksin gjatësor të rrjetës, ashtu dhe të perimetrit të thesit;
- h) “thes në formë xhepi”: thes në të cilin lartësia vertikale zvogëlohet drejt pjesës së pasme dhe ku seksionet e tërthorta formojnë përafërsisht një elips me akset e mëdha identike ose me akset e mëdha zvogëluese. Pjesa e pasme e thesit është e përbërë nga një panel i vetëm i palosur ose nga panelet e pasme si të sipërm, ashtu dhe të poshtëm, të qepur së bashku në mënyrë të tërthortë në krahasim me aksin gjatësor të rrjetës;
- i) “litari transversal”: litari i jashtëm dhe i brendshëm që ecën tërthorazi në krahasim me aksin gjatësor të rrjetës, i vendosur në pjesën e pasme të thesit përgjatë vijës së bashkimit të dy paneleve të sipërme dhe të poshtme ose përgjatë palosjes së panelit të vetëm të poshtëm; mund të jetë një zgjatim i litarit anësor ose një litar i veçantë;
- j) “perimetri-cirkumferenca” i seksionit të një pjese rrjete romboidale të një trate: numri i syzeve në këtë seksion shumëzuar për dimensionet e syzes të tërhequr;
- k) “perimetri-cirkumferenca” i seksionit të një pjese rrjete me syze kuadrate të një trate: numri i syzeve në këtë seksion e shumëzuar me gjatësinë e syzes.

a) Montimi i pajisjeve të autorizuar të tratat

1. Si përjashtim i nenit 8 të rregullores nr.4, datë 24.10. 2008, një pajisje mekanike me mbyllje zinxhir, e vendosur tërthorazi në krahasim me aksin gjatësor të rrjetës ose në mënyrë gjatësore, mund të përdoret për mbylljen e hapjes që përdoret për zbrazjen e thesit në formë xhepi.

2. Largësia midis mbylljes zinxhir në mënyrë të tërthortë dhe syzeve të pasme të thesit nuk duhet të jetë më e madhe se një metër.

b) Kërkesat për armimin

1. Tratat nuk mund të jenë të pajisura me thes në formë topi. Numri i syzeve me madhësi të barabartë nuk duhet të rritet nga cepi i përparmë deri te cepi i pasëm në secilën nga perimetrat e thesit.

2. Perimetri i pjesës së pasme të trupit të tratës (pjesa konike) ose të parathesit (pjesa cilindrike) nuk duhet të jetë më e vogël se perimetri i pjesës së përparme të thesit *stricto sensu*. Në rastin e një thesi me syze kuadrate, në veçanti, perimetri i pjesës së pasme të trupit të tratës apo e parathesit duhet të jetë nga 2 deri 4 herë më e madhe sesa perimetri i pjesës së përparme të thesit *stricto sensu*.

3. Te tratat mund të futen dhe pjesë rrjete me syze kuadrate, e vendosur përpara parathesit ose në çfarëdo pike ndërmjet pjesës së përparme të parathesit dhe pjesës së pasme të thesit; këto

panele nuk duhet në asnjë mënyrë të bllokohen nga zgjatime të brendshme ose të jashtme të thesit.

Këto duhet të jenë të përbëra nga pjesë rrjete pa nyje ose me nyje të palëvizshme dhe të futen në mënyrë të tillë që syzet të rrinë të hapura gjatë gjithë aktivitetit të peshkimit..

4. Në mënyrë të ngjashme, pajisjet teknike që kanë si qëllim përmirësimin e selektivitetit të tratës, të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën “b”, pika 3, mund të autorizohen konform procedurës parashikuar në nenin 29 të kësaj rregulloreje.

5. Është e ndaluar mbajtja në anije ose përdorimi i çfarëdo lloj trate, thesi i së cilës është i përbërë, plotësisht ose pjesërisht, me copë rrjete të ndryshme nga ajo me syze kuadrate apo syze në formë diamanti, përveçse kur ato janë të autorizuar sipas procedurës së parashikuar në nenin 29 të kësaj rregulloreje.

6. Pikat 4 dhe 5 nuk aplikohen te tratat e zallit në të cilat thesi ka syze me madhësi më të vogël se 10 mm.

7. Si përjashtim të nenit 6, pika 4 të rregullores nr.4, datë 24.10. 2008, te tratat koçe (fundore) madhësia e syzeve të këmishës së thesit nuk duhet të jenë më të vogla se 120 milimetra në rast se madhësia e syzeve të thesit është më e vogël se 60 milimetra. Nëse dimensionin e syzeve të rrjetës është e barabartë ose më e madhe se 60 milimetra, aplikohet neni 6, pika 4 të rregullores nr. 4, datë 24.10. 2008.

8. Thesi në formë xhepi duhet të ketë vetëm një hapje që lejon zbrazjen e tij.

9. Gjatësia e litarit transversal nuk duhet të jetë më e vogël se 20% e perimetrit të thesit.

10. Perimetri i këmishës së thesit, siç përcaktohet në nenin 6 të rregullores nr.4, datë 24.10. 2008, duhet të jetë së paku 1,3 herë më e madhe se ajo e thesit për tratat e koçes (fundore).

11. Është e ndaluar mbajtja në anije ose përdorimi i çfarëdo trate të përbërë plotësisht ose pjesërisht, në thes, të pjesëve të rrjetës të formuara nga një fije e vetme me trashësi më të madhe se 3,0 milimetra.

12. Është e ndaluar mbajtja në anije ose përdorimi i çfarëdo trate e përbërë plotësisht ose pjesërisht, në thes, të pjesëve të rrjetës të formuara me fije të shumëfishtë.

13. Pjesët e rrjetës me trashësi të fijes më të madhe se 6 milimetra janë të ndaluara në çfarëdo pjese të tratave të koçes (fundore).

## SHTOJCA II KËRKESAT NË LIDHJE ME VEGLAT E PESHKIMIT

### Përkufizime

Në kuptim të kësaj shtojce aplikohen përkufizimet e mëposhtëme:

1. Gjatësia e rrjetës korrespondon me atë të cimës së tapës; gjatësia e rrjetave fundore dhe e rrjetave fikse notuese mund të përcaktohet dhe në bazë të peshës osë vëllimit të masës së tyre.

2. Lartësia e rrjetës korrespondon me shumën e lartësive të syzeve kur janë të lagura, përfshirë dhe nyjet, të tërhequra pingul me cimën e tapës.

1. Dragat

Gjerësia maksimale e lejuar për dragat është 3 metra.

2. Rrjetat me rrethim (koshilokët dhe tratat pa cimë mbyllëse)

Gjatësia e copës së rrjetës kufizohet në 800 metra dhe lartësia maksimale është 120 metra, përveçse për koshilokët e tonit.

3. Rrjetat fikse fundore

Mrezhat dhe njicat fundore

1. Lartësia maksimale e një mrezhe nuk mund t'i kalojë 4 metrat.

2. Lartësia maksimale e një njice fundore nuk mund t'i kalojë 10 metrat.

3. Është e ndaluar mbajtja në anije ose vendosja e më shumë se 6.000 metra mrezhë, njicë fundore për anije, duke pasur parasysh që, nga janari 2008, në rastin e një peshkatari të vetëm

nuk mund të kalohen 4.000 metrat, të cilave mund t'i shtohen dhe 1.000 metra të tjera në rastin e një peshkatari të dytë dhe 1.000 metra të tjerë në rastin e një peshkatari të tretë. Deri në 31 dhjetor 2007 këto rrjeta nuk mund të tejkalojnë 5.000 metrat në rastin e një ose dy peshkatarëve dhe 6.000 metrat në rastin e një peshkatari të tretë.

4. Diametri i monofilamentit apo fijes së rrjetës nuk mund të tejkalojë 0,5 milimetrat.

5. Si përjashtim të pikës 2, njicat fundore me gjatësi maksimale më të vogël se 500 metra mund të kenë një lartësi të përgjithshme deri në 30 metra. Është e ndaluar mbajtja në anije apo hedhja e më shumë se 500 metra njicë fundore në rastet kur ajo e tejkalon 10 metrat e lartësisë, të përcaktuara në pikën 2.

Rrjetë fikse fundore e kombinuar (mrezhë + njicë)

1. Lartësia maksimale e rrjetës fikse fundore të kombinuar nuk mund t'i kalojë 10 metrat.

2. Është e ndaluar mbajtja në anije apo vendosja e më shumë se 2.500 metra rrjetë të kombinuar për anije.

3. Diametri i monofilamentit apo të fijes së rrjetës së njicës nuk mund të jetë më i madh se 0,5 mm.

4. Si përjashtim të pikës 1, një rrjetë fikse fundore e kombinuar që ka një gjatësi maksimale më të vogël se 500 metra mund të ketë një lartësi maksimale 30 metra. Është e ndaluar mbajtja në anije ose vendosja e më shumë se 500 metra rrjetë fikse fundore të kombinuar kur ajo i kalon kufirin e lartësisë 10 metra të përcaktuar në pikën 1.

4. Parangallët fundorë

1. Ndalohet mbajtja në anije ose vendosja e më shumë se 1.000 grepave për person në anije me një kufi maksimal prej 5.000 grepash për anije peshkimi.

2. Si përjashtim i pikës 1, çdo anije që ndërmerr dalje më të gjata se 3 ditë mund të mbajë në anije një maksimum prej 7.000 grepash.

5. Kurthe për peshkimin e krustaceve të ujërave të thella

Është e ndaluar mbajtja në anije ose vendosja e më shumë se 250 kurtheve për anije.

6. Parangallë sipërfaqësorë (notues)

Është e ndaluar mbajtja në anije ose vendosja e më shumë se:

1. 2.000 grepave për anije, që kanë si objekt peshkimin e tonit të kuq (*Thunnus thynnus*), kur ky lloj përfaqëson të paktën 70% të zënieve në peshë të gjallë, të matura pas seleksionimit;

2. 3.500 grepave për anije, që kanë si objekt peshkimin e peshkut shtizë (*Xiphias gladius*), kur ky lloj përfaqëson të paktën 70% të zënieve në peshë të gjallë, të matura pas seleksionimit;

3. 5.000 grepave për anije që kanë si objekt peshkimin e tonit të bardhë (*Thunnus alalunga*), kur ky lloj përfaqëson të paktën 70% të zënieve në peshë të gjallë, të matura pas seleksionimit;

4. Si përjashtim i pikave 1, 2 dhe 3, çdo anije peshkimi që ndërmerr një dalje më të gjatë se 2 ditë, mund të mbajë në anije një numër të njëjtë grepash rezervë.

7. Tratat

Specifikimet teknike që kanë lidhje me kufizimin e përmasave maksimale të cimës së tapës, cimës së plumbit, të circumferencës apo perimetrit të rrjetës dhe të numrit maksimal të tratave në pajisjet e shumëfishta do të miratohen me rregullore te veçantë.

### SHTOJCA III

#### DIMENSIONET MINIMALE TË ORGANIZMAVE DETARE

| EMRI SHKENCOR        | EMRI SHQIP    | Dimensioni minimal |
|----------------------|---------------|--------------------|
| 1. Peshqit           |               |                    |
| Dicentrarchus labrax | Levrek        | 25 cm              |
| Diplodus annularis   | Sargu bishtzi | 12 cm              |
| Diplodus puntazzo    | Sharan        | 18 cm              |

|                                     |                |                        |
|-------------------------------------|----------------|------------------------|
| Diplodus sargus                     | Sargu          | 23 cm                  |
| Diplodus vulgaris                   | Sargua         | 18 cm                  |
| Engraulis engrasicolus <sup>1</sup> | Açuga          | 9 cm                   |
| Epinephelus spp.                    | Kerrat         | 45 cm                  |
| Lithognathus mormyrus               | Murra          | 20 cm                  |
| Merluccius merluccius***            | Merluci        | 20 cm                  |
| Mullus spp.                         | Barbunët       | 11 cm                  |
| Pagellus acarne                     | Mormuri i eger | 17 cm                  |
| Pagellus bogaraveo                  | Spalce e kuqe  | 33 cm                  |
| Pagellus erythrinus                 | Spalce e kuqe  | 15 cm                  |
| Pagrus pagrus                       | Pagri          | 18 cm                  |
| Polyprion americanus                | Kerr fundi     | 45 cm                  |
| Sardina pilchardus **               | Sardelja       | 11 cm                  |
| Scomber spp.                        | Skumri         | 18 cm                  |
| Solea vulgaris                      | Gjuhez kanali  | 20 cm                  |
| Sparus aurata                       | Kocja          | 20 cm                  |
| Trachurus spp.                      | Stavridhët     | 15 cm                  |
| 2. Krustacetë                       |                |                        |
| Hommarus gammarus                   |                | 105 mm CL<br>300 mm TL |
| Nephrops norvegicus                 | Skampi         | 20 mm CL<br>70 mm TL   |
| Palinuridae                         | Aragostat      | 90 mm CL               |
| Parapenaeus longirostris            | Karkaleci rozë | 20 mm CL               |
| 3. Molusqet bivalvorë               |                |                        |
| Pecten jacobaeus                    |                | 10 cm                  |
| Venerupis spp.                      |                | 25 mm                  |
| Venus spp.                          |                | 25 mm                  |

TL – Gjatësia e përgjithshme; CL – Gjatësia e karapaksit

<sup>1</sup> Açuga: mund të konvertohet dimensionimi minimal në 110 individë për kilogram

(\*\*) Sardelja: mund të konvertohet dimensionimi minimal në 55 individë për kilogram

\*\*\* Merluci: Megjithatë deri në 31 Dhjetor 2010, lejohet një kufi tolerance prej 15 % në peshë të individëve të merlucit të përfshirë në grup gjatësinë midis 15 dhe 20 centimetra. Ky kufi tolerance respektohet si nga anijet e peshkimit, në det të hapur ose në vendin e zbarkimit, ashtu si dhe në tregjet e peshkut të shitjes së parë pas zbarkimit. Ky kufi respektohet dhe në secilin transaksion tregtar të mëtejshëm në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.

#### SHTOJCA IV MATJA E DIMENSIONEVE TË ORGANIZMAVE DETARË

1. Dimensionimi i një peshku matet, siç është treguar dhe në figurën 1, nga cepi i përparmë i turirit deri në cepin e pendës së bishtit.
2. Dimensionimi i skampit (*Nephrops norvegicus*) është matur siç është treguar në figurën 2:
  - në gjatësinë e karapaksit, paralelisht me linjën mediane, duke filluar nga pjesa e pasme e njëres nga orbitat deri në pikën e mesme të kufirit distal kurrizor të karapaksit, ose
  - në gjatësi totale, nga maja e rostrumit deri në ekstremin e pasëm të telsonit duke përjashtuar setat.
3. Dimensionimi i astakuas (*Hommarus gammarus*) matet, siç është treguar në figurën 3:

- në gjatësinë e karapaksit, paralelisht me linjën mediane, duke filluar nga pjesa e pasme e njërës nga orbitat deri në pikën e mesme të kufirit distal kurrizor të karapaksit, ose
- në gjatësi totale, nga maja e rostrumit deri në ekstremin e pasëm të telsonit duke përjashtuar setat.

4. Dimensioni i aragostës (*Palinuridae*) matet, siç është treguar në figurën 4, në gjatësi të karapaksit, paralelisht me linjën mediane, nga maja e rostrumit deri në pikën e mesme të kufirit distal kurrizor të karapaksit.

5. Dimensioni i një molusku bivalvor matet, siç është treguar në figurën 5, në pjesën më të gjatë të guaskës.





Figura 1



Homarus (astakua)

Nephrops (skampi)

a) Gjatësia e karapaksit

b) gjatësia totale

Figura 3

Figura 2




Figura 4




Figura 5

SHTOJCA V  
LISTA E LLOJEVE SHUMË MIGRUESE TË PESHKIMIT ARGËTUES, TË DHËNAT E  
SECILËS REGJISTROHEN

- Toni pendgjate: *Thunnus alalunga*
- Toni i kuq: *Thunnus thynnus*
- Tonno sy madh: *Thunnus obesus*
- Tonnetto striato: *Palamid*
- Pallamiti: *Sarda sarda*
- Toni pend verdhe: *Thunnus albacares*
- Toni pend zi: *Thunnus atlanticus*
- Trup: *Euthynnus* spp.
- Toni: *Thunnus maccoyii*
- Tombarelli: *Auxis* spp.
- Pesce castagna: *Bramidae*
- Aguglie imperiali o marlin: *Tetrapturus* spp.; *Makaira* spp.
- Pesci vela: *Istiophorus* spp.
- Peshku shtizë: *Xiphias gladius*
- Sqepaluk: *Scomberesox* spp.; *Cololabis* spp.

- Korifena: *Coryphaena hippurus*; *Coryphaena equiselis*
- Peshkaqenet: *Hexanchus griseus*; *Cetorhinus maximus*; *Alopiidae*; *Alopiidae Rhincodon typus*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Suridae*; *Lamnidae*
- Cetacete (balenat dhe focene): *Physeteridae*; *Belaenopteridae*; *Balenidae*; *Eschrichtiidae*; *Monodontidae*; *Ziphiidae*; *Delphinidae*.